



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202300515/4

Tiranë ___/___/2023

Lënda: Rekomandim për shfuqizimin e Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1657, datë 12.07.2022, për përjashtimin nga Policia e Shtetit të shtetasit P.B. dhe rikthimin e tij në strukturat e Policisë së Shtetit.

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT
Tiranë

Për dijëni : SINDIKATËS SË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT
Rr. "Hodo Beg", Pall. 31
Tiranë

Me shkresën nr. K2/P4-2 prot., datë 02.06.2023, ju kemi vënë në dijëni se në institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur një ankesë shtetasi P.B.. Ankuesi shkruan se ka qenë punonjës i Policisë së Shtetit me gradën "Nënkomisar" dhe ka ushtruar detyrën funksionale "Specialist pranë Sallës së Komandimit" në Komisariatit e Policisë Kavajë.

Ndaj tij ka filluar procedura disiplinore për shkak se në datën 04.05.2022, rreth orës 19:10, në ambientet e dhomave të sigurisë në Komisariatit e Policisë Kavajë është konstatuar vetëvarja e shtetasit I.M., i cili ishte i arrestuar si i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Vjedhja", parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal.

Ankuesi shkruan se në kohën e ndodhjes së ngjarjes së rëndë kishin kaluar mbi 20 minuta pas dorëzimit të detyrës kolegut të tij dhe se kur është njoftuar për situatën ka qenë në banesë. Pasi është paraqitur në komisarjat është arrestuar në flagrancë nga Drejtoria Rajonale e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore Durrës-Kavajë, si i dyshuar për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Nisur nga kjo ngjarje, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me vendimin nr. 203, datë 10.05.2022, ka bërë pezullimin disiplinor të tij nga detyra me motivacionin se, *në datën 05.05.2022 është arrestuar në flagrancë nga Drejtoria Rajonale e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore Durrës-Kavajë, si i dyshuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.*

Ndërkohë, në pikën 2 të këtij vendimi thuhet se: **“Pezullimi të zgjasë deri në ndryshimin e statusit të tij me vendim gjyqësor”**.

Më pas, Departamenti për Sigurinë Publike pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit me vendimin nr. 289, datë 21.06.2022, “Për dhënie mase disiplinore një punonjësi policie” ka vendosur: *“Nënkomisar P.B., me detyrë Specialist pranë Sallës së Komandimit në Komisariatit e Policisë Kavajë, i jepet masa disiplinore “Përjashtim nga Policia....”*.

Në vijim, nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit është nxjerrë urdhri nr. 1657, datë 12.07.2022, për përjashtimin e tij nga Policia e Shtetit në bazë të nenit 205 të Rregullores së Policisë së Shtetit “Sjellje e rëndë diskretituese” dhe nenit 209 “Shkelja e rëndë e attributeve/kompetencave të policisë”.

Përveç sa më sipër, ankuesi shkruan se në lidhje me këtë ngjarje, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë është regjistruar procedimi penal nr. 149 ndaj punonjësve të policisë R.K., B.B. dhe P.B., për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 148 i Kodit Penal.

Pas përfundimit të hetimeve, organi i prokurorisë i ka paraqitur kërkesë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë për dërgimin e çështjes për gjykim ndaj shtetasve R.K. dhe B.B. për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të shtetasit P.B. për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Në përfundim të gjykimit të kësaj çështjeje, Gjykata e Shkallës së Parë Kavajë me vendimin nr. 220, datë 28.12.2022, ndër të tjera ka vendosur: *“... Pushimin e çështjes në ngarkim të shtetasit P.B., i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal...”*. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 13.01.2023.

Ankuesi shkruan se fillimisht ndaj tij me vendimin nr. 203, datë 10.05.2022 është vendosur pezullimi disiplinor deri në ndryshimin e statusit të tij me vendim gjyqësor. Ndërsa më vonë, me vendimin nr. 289, datë 21.06.2022 është vendosur përjashtimi i tij nga Policia e Shtetit. Sipas tij, vendimi i dytë është në kundërshtim të hapur me vendimin e parë sepse në momentin e përjashtimit të tij nga Policia e Shtetit nuk ishte dhënë asnjë vendim fajësie apo pafajësie ndaj tij nga gjykata, por çështja ishte në hetim dhe se ai nuk është marrë në asnjë moment i pandehur por ka qenë në pozitën procedurale të të dyshuarit. Në këtë rast, ndaj tij, nuk është respektuar pika 6 e nenit 222,

të Rregullores së Policisë së Shtetit, e cila parashikon se: “6. Në rastet e përcaktuara në pikën 3, shkronja “c” dhe “ç” të këtij neni, pezullimi disiplinor i punonjësit, zgjat deri në ndryshimin e statusit të tij, me vendim gjyqësor”. Gjithashtu nuk është respektuar as neni 225/1/a i Rregullores së Policisë së Shtetit, ku parashikohet se: “1. Hetimi disiplinor për shkelje të rëndë disiplinore pezullohet nga Drejtoria i Standardeve Profesionale, në këto raste: a) kur për të njëjtën çështje pritet një vendim-njoftim nga një organ tjetër i zbatimit të ligjit;”.

Përveç sa më sipër ankuesi shkruan se gjatë kohës që ndaj tij ka filluar dhe është zhvilluar procedura administrative/ecuria disiplinore, ai nuk është njoftuar nga struktura kompetente, Drejtoria e Standardeve Profesionale dhe nuk i është vënë në dispozicion raporti i përpliluar në përfundim të hetimit të këtij rasti. Gjithashtu ankuesi pretendon se nuk i janë vënë në dispozicion zyrtarisht as vendimet e marra ndaj tij, ndonëse vendndodhja e tij, i arrestuar në IEVP Peqin, dihej nga këto struktura.

Po ashtu ankuesi pretendon se, që në momentin e përjashtimit nga Policia e Shtetit ai është konsideruar padrejtësisht fajtor në lidhje me ngjarjen e ndodhur duke mos pritur në këtë mënyrë përfundimin e hetimeve të nisura nga organi i prokurorisë dhe vendimin e gjykatës.

Sipas tij, në rast se do të respektohej procedura ligjore derisa gjykata të shprehej me vendim përfundimtar, edhe vendimmarrja e strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit do të ishte e ndryshme dhe se ai do të vijonte punën në Policinë e Shtetit.

Ndodhur në këto rrethana dhe pasi gjykata ka pushuar çështjen në ngarkim të tij, vendim i cili ka marrë formë të prerë, ai i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit shfuqizimin e vendimit nr. 289, datë 21.06.2022 për përjashtimin e tij nga Policia e Shtetit dhe të Urdhrit nr. 1657, datë 12.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, si dhe rikthimin në detyrë.

Ankuesi pretendon se nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nuk janë marrë në konsideratë kërkesat e tij. Në përgjigjen e dërguar atij me shkresën nr. 250/2-P, datë 03.04.2023 nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore i thuhet se, *nuk mund të rikthehet në polici sepse ai nuk është i liruar me kërkesën e tij ose për shkurtim të funksionit në kuadër të pakësimit të limitit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.*

Së bashku me ankesën, ai na ka dërguar edhe fotokopje të dokumenteve të cituara më sipër, ndërmjet të cilave edhe vendimin nr. 220, datë 28.12.2022 të Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë për pushimin e çështjes në ngarkim të tij për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 13.01.2023.

Në bazë të kërkesës tonë, ju me shkresën nr. 5094/1 prot., datë 16.06.2023, ndërmjet të tjerave na informuat se:

“Ish punonjësit të policisë Nënkomisar P.B., me detyrë Specialist pranë Sallës Operative të Komandimit, në Komisariatit e Policisë Kavajë, pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës me Policinë e Shtetit, më datë 05.05.2022, me urdhrin nr. 1657, datë 12.07.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, me motivacionin *“Ndaj tij merret masa disiplinore e përjashtimit nga Policia”*.”

Me shkresën nr. 250/2-P, datë 03.04.2023, i është kthyer përgjigje z. B., ku i është shpjeguar se sipas përcaktimeve të nenit 49 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, rikthimi në Policinë e Shtetit bëhet në rastet kur punonjësi është liruar me kërkesën e tij, ose për shkurtim të funksionit organik në kuadër të pakësimit të limitit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për hetimin administrativ të rastit i jemi referuar shkeljes së procedurës standarde të punës dhe jo hetimit penal. Mbështetur kjo edhe në nenin 228 të Rregullores së Policisë së Shtetit, “E drejta e fillimit të hetimit disiplinor”, pika 6, ku parashikohet se: *“Për shkelje disiplinore, të cilat përmbajnë elementë të veprës penale, krahas hetimit penal, zhvillohet edhe hetimi disiplinor. Hetimi disiplinor në këto raste, duhet t’i referohet vetëm shkeljeve të përcaktuara në këtë rregullore ose akte të tjera që normojnë punën e policisë dhe jo faktit që punonjësi i policisë është në procedim penal”*.”

Z. B., ka kërkuar rikthimin në strukturat e Policisë së Shtetit, me argumentin se Gjykata e Shkallës së Parë Kavajë, ka vendosur pushimin e çështjes në ngarkim të tij për aktakuzën si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”.

Bazuar në nenin 251 të Rregullores së Policisë së Shtetit, *“Masat disiplinore, me përjashtim të masës “Përjashtim nga Policia”, mund të hiqen nga Drejtori i Policisë së Shtetit, kur nga momenti i ekzekutimit të masës, ka kaluar jo më pak se një e treta e kohës së shlyerjes së saj”*.

Në zbatim të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe Rregullores së Policisë së Shtetit, miratuar me VKM nr. 750, datë 16.09/2015, i ndryshuar, për heqjen e masës disiplinore “Përjashtim nga Policia”, z. B. duhet t’i drejtohet gjykatës dhe pasi të marrë një vendim të formës së prerë, mund t’i drejtohet Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për rikthimin e tij në strukturat e Policisë së Shtetit.”

Nga shqyrtimi i ankesës dhe dokumentacionit të dërguar nga ankuesi, si dhe i përgjigjes së dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit rezulton se, shtetasi P.B. ka qenë i punësuar pranë strukturave të Policisë së Shtetit që nga viti 1992, duke ardhur nga shtresa e të përndjekurve politikë. Në muajin prill të vitit 1999 ai është liruar nga Policia e Shtetit me motivacionin “Për shkurtim të funksionit organik”. Në muajin qershor 2010 ai është rikthyer në strukturat e Policisë së Shtetit. Ndërsa në vitin 2022 ka qenë me

detyrë Specialist pranë Sallës Operative të Komandimit, në Komisariatin e Policisë Kavajë pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, me gradën “Nënkomisar”.

Gjatë periudhës kohore të punës në këto struktura për rreth 20 vjet, ai ka patur vlerësime pozitive dhe nuk ka marrë asnjë masë disiplinore.

Pas ngjarjes së ndodhur në ambientet e dhomave të sigurisë në Komisariatin e Policisë Kavajë në datën 04.05.2022, ku është konstatuar vetëvarja e shtetasit të arrestuar I.M., ai është arrestuar nga strukturat e AMP-së.

Me vendimin nr. 203, datë 10.05.2022, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pika 1, është bërë pezullimi disiplinor nga detyra i ankuesit, me motivacionin se në datën 05.05.2022 është arrestuar në flagrancë nga Drejtoria Rajonale e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore Durrës-Kavajë, si i dyshuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Në pikën 2 të këtij vendimi parashikohet se, ***pezullimi të zgjasë deri në ndryshimin e statusit të tij me vendim gjyqësor.***

Ndërsa, në pikën 4 të tij parashikohet se, gjatë kohës së pezullimit punonjësi i policisë nuk do të trajtohet financiarisht.

Ndërkohë në pikën 5 të vendimit parashikohet se, të drejtat administrative dhe financiare t’i ndërpriten në datën 05.05.2022.

Me vendimin nr. 289, datë 21.06.2022, të Drejtorit të Departamentit për Sigurinë Publike në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit “Për dhënie mase disiplinore një punonjësi policie”, pika 1, është vendosur që, *Nënkomisar P.B., me detyrë Specialist pranë Sallës Operative të Komandimit, në Komisariatin e Policisë Kavajë, pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, t’i jepet masa disiplinore “Përjashtim nga Policia”.*

Në pjesën hyrëse të këtij vendimi parashikohet se: *“Në zbatim të nenit 96, pika 1, gërma “b/iii”, të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, të nenit 240, pika 2, gërma “a” dhe nenit 237, pika 4, të Rregullores së Policisë së Shtetit, miratuar me VKM nr. 750, datë 16.09.2015, e ndryshuar, për shkelje të nenit 205 “**Sjellja e rëndë diskretituese**”, pika 22 “nuk ofron ndihmën e nevojshme për qytetarët, në rastet që kanë të bëjnë me jetën, shëndetin dhe pronën e tyre;”, neni 29 “**Shkelja e rëndë e attributeve/kompetencave të Policisë**”, pika 1, “pa ndonjë arsye bindëse, nuk i përmbush apo dështon në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive të caktuara, të cilat kanë shkaktuar pasoja të rënda në kryerjen e detyrave;”, të kësaj Rregulloreje, si dhe mbështetur në “Raportin përfundimtar” të Drejtorisë së Standardeve Profesionale”.*

Me Urdhrin nr. 1657, datë 12.07.2022 “Për përjashtimin nga Policia e Shtetit të një punonjësi policie”¹, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit është vendosur:

*“1. Nënkomisar P.B., me detyrë Specialist pranë Sallës Operative të Komandimit, në Komisariatit e Policisë Kavajë, pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, të përjashtohet nga Policia e Shtetit me motivacionin “**Ndaj tij merret masa disiplinore e përjashtimit nga Policia**” (për shkelje të rëndë disiplinore të parashikuar në Rregulloren e Policisë së Shtetit, neni 205 “Sjellja e rëndë diskretituese”, neni 29 “Shkelja e rëndë e atributëve/kompetencave të Policisë”).*

2. Të drejtat administrative e financiare t’i ndërpriten më datë 05.05.2022.”

Procedura e hetimit disiplinor e ndjekur ndaj ankuesit ka nisur, ka vijuar dhe më pas ka përfunduar në mënyrë të kundërligjshme, paragjykuese, jo të drejtë dhe jo objektive. Ajo është kryer në kundërshtim të plotë dhe të hapur me Kreun IV të Rregullores së Policisë së Shtetit të emërtuar **“Procedurat për hetimin disiplinor”**, në të cilin rregullohen fillimi dhe përfundimi i hetimit disiplinor duke përcaktuar parimet ku duhet të mbështetet i gjithë procesi administrativ disiplinor, i cili duhet të jetë i drejtë, objektiv dhe transparent, në kuptim të nenit 226/1 të saj.

Ndërkohë ankuesit nuk i janë respektuar të drejtat e garantuara nga neni 221 i Rregullores të emërtuar **“Të drejtat, detyrimet dhe mbrojtja e punonjësit gjatë hetimit disiplinor”** ku parashikohet se:

“Punonjësi ka të drejtë dhe detyrim që gjatë procesit të hetimit disiplinor të:

1. informohet me shkrim në lidhje me shkeljen e dyshuar dhe dëshmitë që i mbështesin shkeljet e tilla;

2. të drejtën e të shprehurit me shkrim në lidhje me shkeljen;

3. të drejtën e mbrojtjes me punonjës brenda strukturave të Policisë, ose me mbrojtës ligjor jashtë strukturave policore;

4. të drejtën e konsultimit me ndonjë këshilltar juridik, apo person tjetër të zgjedhur nga ai, gjatë gjithë procesit të hetimeve;

5. të bashkëpunojë në procesin hetimor;

6. të ankohet ndaj vendimeve disiplinore.”

Në vijim, në nenin 226/2 të Rregullores parashikohet se:

“2. Hetimi disiplinor fillon në momentin kur punonjësi njoftohet zyrtarisht me shkrim, për fillimin e hetimit disiplinor dhe përfundon kur vendimi disiplinor ka marrë formën e prerë dhe i është komunikuar punonjësit”.

¹ Në pjesën hyrëse të këtij urdhri parashikohet se: “Bazuar në nenet 9, pikat 1 dhe 2, shkronja “b” dhe “ç”, 46, pika 4, shkronja “b” të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, në nenin 182, pika 3, shkronja “b” dhe në nenin 252 të Rregullores së Policisë së Shtetit, në Vendimin nr. 289, datë 21.06.2022, të Departamentit për Sigurinë Publike, “Për dhënien e masës disiplinore një punjësi policie”, si dhe shkresën nr. 3618/7, datë 04.07.2022, të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë”.

Në fakt, rezulton e provuar se ankuesi nuk është njoftuar zyrtarisht për fillimin e hetimit disiplinor ndaj tij dhe as i është komunikuar zyrtarisht vendimi disiplinor për “Përrjashtim nga Policia”.

Gjithashtu në këtë rast nga strukturat e Drejtorisë së Standardeve Profesionale nuk është zbatuar detyrimi i parashikuar në nenin 227, pika 6 e Rregullores “Njoftimi për fillimin e hetimit disiplinor”, ku parashikohet se:

“6. Për punonjësit me masë sigurie, në pamundësi të njoftimit të tij, njoftimi për fillimin e hetimit disiplinor, nënshkruhet nga një përfaqësues i sindikatës i cili ka detyrimin të njoftojë punonjësin që është nën hetim disiplinor.”

Ne çojmë se në rastin e ankuesit P.B. ka ekzistuar mundësia e njoftimit të tij në mënyrë zyrtare për fillimin e hetimit disiplinor sepse dihej vendndodhja e tij. Por, ndërkohë në këtë rast nuk është zbatuar as detyrimi për të njoftuar Sindikatën e Punonjësve të Policisë së Shtetit, me qëllim që njoftimi të nënshkruhej nga një përfaqësues i saj, i cili të merrte detyrimin për të njoftuar punonjësin nën hetim disiplinor (ankuesin). Ky fakt provohet nga shkresa e dërguar institucionit tonë nga Sindikata e Punonjësve të Policisë së Shtetit nr. 17/1 prot., datë 12.07.2023. Në këtë shkresë u informuam se, *Sindikata nuk disponon asnjë njoftim zyrtar nga Drejtoria e Standardeve Profesionale pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për pjesëmarrje në procesin administrativ disiplinor të filluar ndaj ish punonjësit të policisë, Nënkomisar P.B. dhe as për vendimin e marrë ndaj tij për përjashtim nga Policia e Shtetit.* Gjithashtu në këtë shkresë Sindikata ngre shqetësimin duke pretenduar se, *Drejtorja e Standardeve Profesionale vazhdon të aplikojë praktika të gabuara të përjashtimeve të punonjësve të policisë, si në rastin e mësipërm, në kundërshtim me Rregulloren e Policisë së Shtetit.*

Sqarojmë se në Rregullore, repektivisht neni 231 “Hetimi disiplinor për punonjësin e Policisë me masë sigurie” është parashikuar se:

“Për punonjësin e Policisë që është me masë sigurie “arrest në burg”, “arrest në shtëpi”, ose “shtrim i përkohshëm në një spital psikiatrik”, procedurat e hetimit disiplinor janë të njëjta sipas përcaktimeve të nenit 230, të kësaj Rregulloreje, me përjashtim të pikës 1, gërma “b/iv”, të nenit 230². Në këto raste, verifikimi dhe shqyrtimi i shkeljes bëhet me pjesëmarrjen e një përfaqësuesi të caktuar nga Sindikata e Policisë.

Sipas konstatimit tonë, pezullimi disiplinor nga detyra i ankuesit i bërë me Vendimin nr. 203, datë 10.05.2022, të Zv.Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, është bërë në bazë të nenit 222/3/ç të Rregullores. Në pikën 2 të këtij vendimi është parashikuar se, **pezullimi të zgjasë deri në ndryshimin e statusit të tij me vendim gjyqësor.**

² Neni 230 “Verifikimi dhe shqyrtimi”

1. Me fillimin e hetimit disiplinor, pas njoftimit me shkrim të personit, kryhen veprimet e mëposhtme:

b) verifikohen faktet në lidhje me:

iv) komunikimin me punonjësin për t’u njohur me variantin e tij të ngjarjeve apo problemit.

Ndërsa Vendimi nr. 289, datë 21.06.2022, i Drejtorit të Departamentit për Sigurinë Publike në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Urdhri nr. 1657, datë 12.07.2022 i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për përjashtimin nga Policia e Shtetit të ankuesit, janë nxjerrë në kundërshtim të plotë dhe të hapur me pikën 2 të Vendimit nr. 203, datë 10.05.2022, të Zv.Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. ***Por theksojmë se më i rëndësishëm është fakti që këto akte administrative janë në kundërshtim me nenin 222, pika 6 të Rregullores, sepse në kohën e nxjerrjes së tyre nuk ishte marrë ende ndonjë vendim gjyqësor për ndryshimin e statusit të tij.***

Në përgjigjen tuaj, dërguar me shkresën nr. 5094/1, datë 16.06.2023, na informoni se për hetimin administrativ të rastit i jeni referuar shkeljes së procedurës standarde të punës dhe jo hetimit penal. Mbështetur kjo edhe në nenin 228 të Rregullores së Policisë së Shtetit, “E drejta e fillimit të hetimit disiplinor”, pika 6, ku parashikohet se: ***“Për shkelje disiplinore, të cilat përmbajnë elementë të veprës penale, krahas hetimit penal, zhvillohet edhe hetimi disiplinor. Hetimi disiplinor në këto raste, duhet t’i referohet vetëm shkeljeve të përcaktuara në këtë rregullore ose akte të tjera që normojnë punën e policisë dhe jo faktit që punonjësi i policisë është në procedim penal”.***

Por në fakt, referuar akteve të nxjerra nga organi juaj ndaj ish punonjësit të policisë P.B. të cilat i cituam më sipër si dhe nga verifikimet e bëra nga ana jonë në Komisariatit e Policisë Kavajë, ***rezulton se është cënuar pika 6 e nenit 228 të Rregullores, sepse hetimi disiplinor në këtë rast, i është referuar vetëm faktit për të cilin punonjësi i policisë ishte në procedim penal, konkretisht Procedurës Standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi i kërkesave/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 925, datë 18.07.2019.***

Gjithashtu, në këtë konkluzion arrijmë edhe duke iu referuar Vendimit nr. 220, datë 28.12.2022, të Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë për pushimin e çështjes në ngarkim të shtetasit P.B., i dyshuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, i cili ka marrë formë të prerë në datën 13.01.2023. Evidentojmë se në faqen nr. 10, paragrafi 5 të tij përshkruhet se:

“Në lidhje me veprimet apo mosveprimet e të dyshuarit P.B., nuk evidentohen veprime apo mosveprime të cilat rrjedhin nga detyrimet e këtij urdhri.

Veprimet e inspektorit të Sallës së Komandimit, i cili mban çelësat e hyrjes në korridorin e dhomave të paraburgimit, rezultojnë në përmbushje të detyrave të parashikuara nga Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm i Policisë së Shtetit nr. 925, datë 18.07.2019 “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi i kërkesave/ankesave të tyre”.

Bazuar në faktet e mësipërme, në mënyrë kronologjike është e qartë dhe praktikisht e përceptueshme, se sjellja e tij ka qenë korrekte në përmbushje të detyrimeve për shkak të pozicionit si inspektor i Sallës së Komandimit, ku siç rezulton nga procesverbali i kontrollit personal, deklarimet dhe pamjet filmike, i arrestuari është kontrolluar dy herë nga punonjësit e tjerë të përgjegjshëm në funksion konkret të kryerjes së këtij detyrimi.”

Përveç sa më sipër, nëse ankuesi do të kishte kryer shkelje të tjera ligjore, me natyrë disiplinore, përveç atyre për të cilën ka filluar procedimi penal dhe është arrestuar, nga ana juaj nuk na është dhënë asnjë informacion në përgjigjen e dërguar.

Sjellim në vëmendje se koncepti i “Përrjashtimit nga Policia e Shtetit”, është parashikuar në nenin 6, pika 18 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

“18. “Përrjashtimi nga policia” është ndërprerja e marrëdhënieve juridike të punonjësit të policisë.”

Ndërsa në nenin 46³ të këtij ligji parashikohet ndërprerja e marrëdhënieve të punës të punonjësit të policisë, ku përfshihet dhe përrjashtimi nga policia në rastet e parashikuara në këtë ligj.

Po ashtu, përrjashtimi i një punonjësi nga Policia e Shtetit është parashikuar edhe në nenin 182⁴ të Rregullores së Policisë së Shtetit.

³ 1. Punonjësi i policisë ndërpret marrëdhëniet e punës kur lirohet ose përrjashtohet nga policia.

2. Punonjësi i policisë lirohet nga policia në rastet kur:

a) mbush moshën për pension pleqërie;

b) deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor, sipas ligjit;

c) kërkon vetë të lirohet;

ç) shkurtohet funksioni në kuadër të pakësimit të limitit të përgjithshëm organik të policisë;

d) konstatohet pavlefshmëria e aktit administrativ të pranimit;

dh) vdes apo kur merr formë të prerë vendimi për shpalljen e zhdukjes ose të vdekjes së tij;

e) humbet shtetësinë shqiptare;

ë) merr formë të prerë vendimi i gjykatës për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar.

3. Punonjësit të policisë, të cilit i shkurtohet funksioni organik në kuadër të pakësimit të limitit të përgjithshëm organik të policisë dhe nuk ka vend të lirë për gradën që mban, sipas shkronjës “ç”, të pikës 2, të këtij neni, i ofrohet një funksion i një niveli më të ulët, duke ruajtur gradën për një periudhë deri në një vit. Pas kalimit të këtij afati, në pamundësi sistemimi për gradën që ka, punonjësi lirohet nga policia.

4. Punonjësi i policisë përrjashtohet nga policia në këto raste:

a) kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

b) kur ndaj tij merret masa disiplinore e përrjashtimit nga policia.

5. Punonjësi i policisë, i cili ndërpret marrëdhëniet e punës në rastet e pikës 2, shkronjat “ç”, “d” dhe “ë”, dhe të pikës 4, shkronja “b”, ka të drejtë të ankohet në komisionin e apelimit ose drejtpërdrejt në gjykatë.

6. Rregullat dhe procedurat e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës përcaktohen në Rregulloren e Policisë.

⁴ Neni 182 “Ndërprerja e marrëdhënieve të punës”

1. Punonjësi i Policisë ndërpret marrëdhëniet e punës kur lirohet ose përrjashtohet nga Policia....

3. Punonjësi i Policisë përrjashtohet nga Policia në rastet kur:

a) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale;

b) ndaj tij merret masa disiplinore e përrjashtimit nga Policia.

Në nenin 6, pika 24 të ligjit nr.108/2014, jepet përkufizimi i "Shkeljes disiplinore" e cila është *çdo veprim ose mosveprim i punonjësit të policisë, që bie në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore, objekt i punës së Policisë dhe që nuk përbën vepër penale*. Ndërsa në nenin 95/1 të ligjit 108/2014, parashikohet shprehimisht se: *"Shkelje disiplinore është çdo veprim ose mosveprim i punonjësit të Policisë, që bie në kundërshtim me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në Rregulloren e Policisë"*.

Neni 96/3 i këtij ligji, delegon përcaktimin e llojeve të shkeljeve disiplinore në Rregulloren, por në pikën 1 të tij, parashikon masat disiplinore për dy kategoritë e shkeljeve që njihen nga ky ligj, *të lehta dhe të rënda*. Sipas kësaj dispozite, punonjësi i policisë që kryen shkelje disiplinore ndëshkohet disiplinarisht:

- a) Për shkelje të lehta disiplinore me masat: i) vërejtje; ii) vërejtje me paralajmërim.
- b) Për shkelje të rënda disiplinore me masat: i) shtyrje e afatit të gradimit deri në 2 vjet; ii) ulje me një gradë për një periudhë deri në 6 muaj; iii) përrjashtim nga Policia.

Në nenin 46 të ligjit nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit", i titulluar "Ndërprerja e marrëdhënieve të punës të punonjësit të policisë", pika 1 e tij parashikon se: *"Punonjësi i policisë ndërpret marrëdhëniet e punës kur lirohet ose përrjashtohet nga policia"*.

Rastet e përrjashtimit parashikohen në pikën 4 të së njëjtës dispozite, e cila përcakton se: *"Punonjësi i policisë përrjashtohet nga Policia në këto raste:*

- a) *kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;*
- b) kur ndaj tij merret masa disiplinore e përrjashtimit nga policia."

Pika 5 e nenit 46 të ligjit 108/2014, parashikon se punonjësi i policisë, i cili ndërpret marrëdhëniet e punës në rastin e pikës 4, shkronja "b", ka të drejtë të ankohet në Komisionin e Apelit ose drejtpërdrejtë në gjykatë dhe sipas pikës 6, rregullat dhe procedurat e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës përcaktohen në Rregullore.

Ndërkohë procedura e shqyrtimit të shkeljeve disiplinore, përcaktohet në pikat kryesore të saj nga vetë ligji 108/2014, në nenin 95 të tij.

Duke analizuar dispozitat e cituara më sipër, rezulton se marrëdhënia e punës me Policinë e Shtetit ka një karakter të posaçëm dhe për këtë arsye, si pranimi në këtë organ, ashtu edhe ndërprerja e marrëdhënies së punës nëpërmjet lirit apo përrjashtimit, janë detajuar specifikisht nga ana e ligjvënësit, duke mos e lënë rregullimin e kësaj marrëdhënie në diskrecionin e punëdhënësit, sipas parashikimeve të përgjithshme të Kodit të Punës.

Neni 237 i Rregullores së Policisë së Shtetit parashikon masat parandaluese dhe disiplinore për punonjësit e policisë. Në pikën 3 të këtij neni parashikohet se *masat parandaluese janë masat "Këshillim" dhe "Tërheqje vëmendje"*. Në vijim, në pikën 4 të tij, përcaktohet se:

“Në rastet kur punonjësi ndëshkohet me masë disiplinore, për shkelje të lehta disiplinore, ndaj tij jepen masat "vërejtje" ose "vërejtje me paralajmërim" dhe për shkelje të rëndë disiplinore jepen masat "shtyrje e afatit të gradimit deri në 2 vjet", "ulje me një gradë për një periudhë deri në 6 muaj" ose "përkrahje nga policia". (sipas artikullimit të nenit 96 të ligjit 108/2014).

Ndërsa neni 204 i Rregullores liston kategoritë e veprimeve që konsiderohen shkelje të rënda disiplinore⁵.

Në nenin 205 të saj “Sjellja e rëndë diskretituese”, pika 22, parashikohet se: “Punonjësi është përgjegjës për sjellje të rëndë diskretituese, nëse: nuk ofron ndihmën e nevojshme për qytetarët, në rastet që kanë të bëjnë me jetën, shëndetin dhe pronën e tyre;”.

Neni 209 i Rregullores, konsideron një ndër shkeljet e rënda, situatat që vlerësohen se përbëjnë “Shkelje të rëndë të attributeve/kompetencave të Policisë”. Pika 1 e nenit 209 të Rregullores liston si një ndër to, situatën kur punonjësi është përgjegjës për shkelje të rëndë të attributeve/kompetencave të Policisë, nëse: “1. pa ndonjë arsye bindëse, nuk i përmbush apo dështon në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi të caktuara, të cilat kanë shkaktuar pasoja të rënda në kryerjen e detyrave;”.

Në rastin konkret, ankuesi është përjashtuar nga Policia e Shtetit, Urdhri nr. 1657, datë 12.07.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, i cili ka konkluduar mbi ligjshmërinë e vendimmarrjes për shkeljen e rëndë disiplinore të atribuar ankuesit, parashikuar në nenet 205/22 dhe 209/1 të Rregullores, sipas Vendimit nr. 289, datë 21.06.2022, i Drejtorit të Departamentit për Sigurinë Publike në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Referuar akteve të përmendura më lart konstatojmë se, procedimi disiplinor ndaj ankuesit është iniciuar për shkak se ai është arrestuar në flagrancë nga Drejtoria Rajonale e AMP Durrës-Kavajë, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”.

Ndaj këtyre akteve ankuesi nuk ka ushtuar ankim administrativ pranë Komisionit të Apelit, sepse nuk është vënë në dijeni zyrtarisht si për fillimin e procesit disiplinor ashtu edhe për vendimet e marra në ngarkim të tij.

Ne vlerësojmë se procedura e ndjekur nga strukturat kompetente të Policisë së Shtetit për përjashtimin nga ky organ të ankuesit P.B. vijnë në kundërshtim me ligjin dhe aktet nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e këtij organi. Gjithashtu ato bien ndesh edhe me

⁵ Kategoritë e shkeljeve të rënda disiplinore

1. Shkelje e rëndë disiplinore konsiderohet veprimi ose mosveprimi i punonjësit të Policisë, punonjësit që bashkëpunon me të, ose atij që nxit kryerjen e shkeljeve, që ka sjellë pasoja të rënda dhe është kryer në kushtet e rrethanave rënduese.

2. Shkelje e rëndë disiplinore, konsiderohet:

d) shkelja e rëndë e attributeve/kompetencave të policisë;

dispozitat e Kodit të Procedurës Administrative⁶ të cilat garantojnë respektimin e parimit të procesit të rregullt ligjor dhe parimin e ligjshmërisë, të drejtat për t'u njoftuar për

⁶ Neni 1 “Qëllimi i ligjit”, ku parashikohet se:

“Ky Kod ka për qëllim të sigurojë realizimin efektiv të funksioneve publike administrative në shërbim të personave, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshëm të tyre, në realizimin e këtyre funksioneve, duke zbatuar parimin e procesit të rregullt ligjor”.

Neni 4 “Parimi i ligjshmërisë”, ku parashikohet se:

“1. Organet publike ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca.

2. Të drejtat apo interesat e ligjshëm të një pale nuk mund të cenohen nga veprimi dministrativ, përveç se kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor.”

Neni 42 “Komunikimi me palët”, ku parashikohet se:

1. Në rastet kur procedura administrative fillohet nga organi i publik, ky i fundit njofton të gjitha palët në proces për fillimin e veprimeve.

2. Njoftimi, sipas pikës 1, të këtij neni, bëhet me shkrim apo në një takim me alën dhe përmban këto të dhëna:

a) adresën postare dhe/ose elektronike të organit publik, që zhvillon procedurën dhe nëpunësin përgjegjës për të;

b) informacion lidhur me kompetencën e organit publik, qëllimin e procedurës dhe çështjet për të cilat do të merren vendime;

c) palët në procedurën administrative;

ç) informacion për të drejtën e njohjes së dosjes dhe zyrën ose vendin ku mund të njihet dosja;

d) informacion për të drejtën e palës për të dëgjuar, mënyrat dhe afatin e ushtrimit të kësaj të drejte;

dh) datën e fillimit të procedurës dhe afatin brenda të cilit do të merret dhe njoftohet vendimi përfundimtar, në rast se zbatohet një afat i tillë.

3. Kur njoftimi bëhet me takim, organi publik mban procesverbal për dokumentimin e veprimit të kryer.

4. Organi publik nuk është i detyruar të komunikojë me palët në rastet kur çështja është “Sekret shtetëror”, sipas klasifikimeve të bëra me ligj ose kur në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme komunikimi mund të cenojë efektivitetin e procedurës administrative.”

Neni 45 “E drejta e palëve për njohje me dosjen”, ku parashikohet se:

1. Të gjitha palët në një procedurë administrative kanë të drejtë të njihen me dokumentet e dosjes së kësaj procedure, si dhe të marrin kopje të tyre.

Neni 47 “E drejta për të paraqitur mendime dhe shpjegime”, ku parashikohet se:

Të gjitha palët, në çdo fazë të procedurës, kanë të drejtë të paraqesin mendime dhe shpjegime për faktet, rrethana apo çështje ligjore, si dhe të depozitojnë prova ose të paraqesin propozime për zgjidhjen e çështjes.

Neni 87 “Njoftimi dhe e drejta për t'u dëgjuar para marrjes së vendimit përfundimtar”, ku parashikohet se:

1. Përpara se të merret vendimi përfundimtar, organi publik, përveç rasteve të parashikuara nga neni 64, i këtij Kodi, njofton palën lidhur me të drejtën e saj për t'u dëgjuar.

2. Njoftimi, sipas pikës 1, të këtij neni, bëhet me shkrim, apo në një takim me palën, dhe përmban këto të dhëna:

a) organin publik që zhvillon procedurën dhe nëpunësin publik përgjegjës;

b) palët e përfshira;

c) informacion për të drejtën e inspektimit të dosjeve dhe zyrës dhe vendin ku kjo mund të ushtrohet;

ç) provat e administruara, rezultatet e hetimit, si dhe rezultatet e pritshme të procedurës administrative dhe motivimin përkatës;

d) informacionin për të drejtën e palës për t'u dëgjuar dhe mënyrën dhe afatin e ushtrimit të kësaj së drejte;

dh) datën e fillimit të procedurës dhe afatin kohor, brenda të cilit do të merret dhe njoftohet vendimi, në qoftë se një afat i tillë është i zbatueshëm.

3. Afati i parashikuar sipas shkronjës “dh”, të pikës 2, të këtij neni, nëse nuk parashikohet nga ligji ose aktet nënligjore, përcaktohet nga organi publik, në përputhje me nenin 53 të këtij Kodi.

Neni 88 “Ushtrimi i së drejtës për t'u dëgjuar”, ku parashikohet se:

1. E drejta e palës për t'u dëgjuar ushtrohet në çdo formë të përshtatshme dhe brenda afatit të përcaktuar nga organi publik.

2. Palët, në ushtrimin e së drejtës për t'u dëgjuar, mund të paraqesin komente edhe për vlerësimin e provave të administruara, rezultatet e hetimit dhe rezultatin e mundshëm të procedurës.

fillimin e procedurës administrative, të njohjes me dosjen, për të paraqitur mendime dhe shpjegime, të njoftimit dhe të drejtën për t'u dëgjuar para marrjes së vendimit përfundimtar, etj.

Duke mos e njoftuar për fillimin e procedurës administrative/disiplinore, ankuesit i është mohuar mundësia për t'u mbrojtur duke ngarkuar një koleg, një përfaqësues të sindikatës apo avokat, sikurse parashikohet në nenet 227/6 e 7, 231 dhe 247/4 të Rregullores së Policisë së Shtetit si dhe nenit 35 të K.Pr.A.. Si pasojë i këtij qëndrimi, ai ka qenë në pamundësi për të ushtruar të drejtën ligjore të ankimit në rrugë administrative në Komisionin Qendror të Apelit ndaj akteve administrative të marra ndaj tij.

Vendimi nr. 289, datë 21.06.2022, i Drejtorit të Departamentit për Sigurinë Publike në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për dhënien e masës disiplinore "Përrjashtim nga Policia" të ankuesit dhe Urdhri nr. 1657, datë 12.07.2022 i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit "Për përjashtimin nga Policia e Shtetit të punonjësit të policisë P.B.", janë marrë në kundërshtim me nenin 100 të K.Pr.A., ku përcaktohet se:

"Akti administrativ i shkruar në letër ose elektronik, si dhe akti administrativ i konfirmuar, sipas nenit 98, pikat 2 dhe 3, të këtij Kodi, duhet të jetë i arsyetuar. Arsyetimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe përmban:

- a) shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë akti;*
- b) shpjegimin e përmbledhur të rezultatit të hetimit administrativ dhe të vlerësimit të provave;*
- c) bazën ligjore të aktit dhe një shpjegim pse kushtet ligjore për zbatimin e tij plotësohen në këtë rast;*
- ç) në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar."*

Duke e ballafaquar përmbajtjen e dy vendimeve të cituara më sipër me përmbajtjen e nenit 100 të K.Pr.A., rezulton se ato janë limituar vetëm me faktin e arrestimit të ankuesit dhe bazën ligjore. Gjithashtu evidentojmë se në asnjë moment nuk janë përshkruar veprimet ose mosveprimet konkrete të ankuesit të cilat përbëjnë shkelje të rënda disiplinore apo sjellje të rëndë diskretituese dhe shkelje të rëndë të attributeve/kompetencave të Policisë së Shtetit të kryer prej tij, si dhe pasojat e rënda që i janë shkaktuar organit të Policisë së Shtetit apo interesit publik. Ndërkohë nuk pasqyrohet asnjë provë e vetme, mbi bazën e cilës të bëhej vlerësimi dhe arsyetimi, në funksion të provueshmërisë së shkeljes disiplinore të pretenduar ndaj ankuesit sipas neneve 205/22 dhe 209/1 të Rregullores lidhur faktin se, e mos ofrimit të ndihmës së nevojshme për qytetarët, në rastet që kanë të bëjnë me jetën, shëndetin dhe pronën e tyre, si dhe faktin tjetër që, pa ndonjë arsye bindëse, nuk i përmbush apo dështon në

3. Organi publik merr vendimin përfundimtar vetëm pas kalimit të afatit të përcaktuar për ushtrimin e së drejtës për t'u dëgjuar nga pala. Mosushtrimi i kësaj së drejte nga ana e palës në afatin e përcaktuar, nuk shkakton shtyrjen e marrjes së vendimit përfundimtar.

përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi të caktuara, të cilat kanë shkaktuar pasoja të rënda në kryerjen e detyrave.

Avokati i Popullit nuk paragjykon as gravitetin e ngjarjes, as ekzistencën e provave në rastin konkret por merr në vlerësim vetëm ato fakte që rezultojnë të provuara nga hetimi administrativ i kësaj ankese.

Përfundimi nga Policia e Shtetit të ankuesit për faktin se është arrestuar si i dyshuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” është tërësisht e pamjaftueshme për të përligjur masën disiplinore sipas kushteve dhe kritereve ligjore për zbatimin e saj në rastin konkret.

Për këto arsye arrijmë në konkluzionin se në rastin konkret, nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit nuk janë respektuar dispozitat përkatëse të Rregullores lidhur me procedurën e hetimit disiplinor ndaj ankuesit, por është vepruar në kundërshtim të plotë dhe të hapur me to. Vendimi nr. 289, datë 21.06.2022, i Drejtorit të Departamentit për Sigurinë Publike në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Urdhri nr. 1657, datë 12.07.2022 i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për përjashtimin nga Policia e Shtetit të punonjësit të policisë P.B.” janë akte administrative të cilat nuk plotësojnë standardet e arsytimit thelbësor e përmbajtësor sipas kritereve ligjore të parashikuara nga neni 100 i K.Pr.A.

Sikurse e përmendëm në analizën tonë, Rregullorja e Policisë së Shtetit, në Kreun IV, me emërtimin “Procedurat për hetimin disiplinor”, përcakton në mënyrë të detajuar procedurën e nisjes, zhvillimit si dhe përfundimit të procesit disiplinor, i cili përmbillet me urdhrin për përjashtimin nga detyra të punonjësit të policisë.

Duke vlerësuar aktet e nxjerra nga strukturat e Policisë së Shtetit ndaj ankuesit nga pikëpamja e zbatimit të parimit të ligjshmërisë, bazueshmërisë së tyre në aktet normative, rezulton e provuar se këto struktura nuk e kanë zbatuar këtë parim të rëndësishëm në procesin disiplinor të zhvilluar ndaj shtetasit P.B., pasi ato nuk i kanë respektuar dhe zbatuar detyrimet ligjore, duke pasqyruar nxjerjen e këtyre akteve në kundërshtim me nenet 226, 228, 229, 230, të Rregullores së Policisë së Shtetit⁷.

⁷ Neni 226 “Fillimi dhe përfundimi i hetimit disiplinor”

1. Hetimi disiplinor duhet të jetë i drejtë, objektiv dhe transparent.

Neni 228 “E drejta e fillimit të hetimit disiplinor”

6. Për shkelje disiplinore, të cilat përmbajnë elementë të veprës penale, krahas hetimit penal, zhvillohet edhe hetimi disiplinor. Hetimi disiplinor në këto raste, duhet t’i referohet vetëm shkeljeve të përcaktuara në këtë rregullore ose akte të tjera që normojnë punën e policisë dhe jo faktit që punonjësi është në procedim penal.

Neni 229 “Parime të përgjithshme për hetimin disiplinor”

Punonjësi i policisë që kryen hetimin disiplinor duhet të kujdeset që në çdo rast të manifestojë paanshmëri dhe integritet moral e profesional, gjatë procesit të hetimit disiplinor. Ai duhet që:

4. të grumbullojë dhe administrojë, të gjitha faktet e provat në interes të hetimit disiplinor.

Neni 230 “Verifikimi dhe shqyrtimi”

2. Para dhënies së masës disiplinore, shqyrtohen edhe:

Motivacioni i përjashtimit nga Policia e Shtetit të ankuesit për shkeljen e rëndë disiplinore të kategorizuar si sjellje e rëndë diskretituese dhe shkelje e rëndë e attributeve/kompetencave të policisë, bazuar në nenin 204/2/a/d të Rregullores, të cilave u referohen aktet administrative të nxjerra ndaj ankuesit janë të pabazuara në prova.

Veprimet apo mosveprimet e ankuesit janë kategorizuar si shkelje e rëndë disiplinore e parashikuar nga nenet 196, 204, 205 dhe 209 të Rregullores.

Sipas këtyre dispozitave, shkelje e rëndë disiplinore konsiderohet veprimi ose mosveprimi i punonjësit të policisë, punonjësit që bashkëpunon me të, ose atij që nxit kryerjen e shkeljeve, që ka sjellë pasoja të rënda dhe është kryer në kushtet e rrethanave rënduese. Ndërkohë që në aktet administrative të nxjerra ndaj ankuesit, nuk analizohet konkretisht se cilat janë veprimet apo mosveprimet e kryera nga ana e ankuesit, cilat janë provat konkrete që vërtetojnë se, nga ana e tij nuk është ofruar ndihma e nevojshme për qytetarët, në rastet që kanë të bëjnë me jetën, shëndetin dhe pronën e tyre ose nga ana e tij pa ndonjë arsye bindëse nuk janë përmbushur apo ka dështuar në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi të caktuara, që kanë shkaktuar pasoja të rënda në kryerjen e detyrave.

Pra, në rastin konkret nga strukturat e Policisë së Shtetit gjatë procesit disiplinor nuk është administruar asnjë provë, për të vërtetuar motivacionin se ankuesi ndodhet në kushtet e shkeljes disiplinore sipas përcaktimit të nenit 209/1 të Rregullores. Në këto kushte, aktet e nxjerra nga strukturat e Policisë së Shtetit bien në kundërshtim me nenin 81 “Vlerësimi i provave” të K.Pr.A., i cili parashikon se: “Organi publik çmon, sipas bindjes së tij, se cilat fakte konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ”.

Referuar kësaj dispozite rezulton që strukturat vendimmarrëse të procesit disiplinor nuk kanë mundur/arritur të administrojnë edhe një provë të vetme, ndonëse kjo dispozitë kërkon më shumë se një provë kur përcakton “të gjitha provave së bashku”. Mungesa e këtyre provave për të vërtetuar shkeljen disiplinore të atribuar ankuesit, nga strukturat e Policisë së Shtetit, ndonëse ky organ ka barrën e provës për ta vërtetuar pretendimin e shkeljes disiplinore, i bën aktet administrative të nxjerra ndaj ankuesit të pabazuara në ligj.

Barra e provës për të provuar ligjshmërinë e akteve administrative gjen mbështetje në nenin 82/1 të Kodit të Procedurës Administrative i cili parashikon se: “1. Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë,”, si dhe në nenin 35, pika 1 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” të

b) sjelljet e identifikuar, si dhe rrethanat që duhen provuar në këto raste.

ndryshuar, ku përcaktohet se: "Organi publik ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e aktit administrativ, kontratës administrative dhe të veprimit tjetër administrativ, të nxjerrë jo me kërkesë të ankuesit, si dhe faktet që ai ka parashtruar dhe ka vënë në themel të veprimtarisë së kundërshtuar në gjykatë".

Strukturat pjesëmarrëse në procesin disiplinor të filluar ndaj ankuesit, referojnë në lidhje me arrestimin e tij në flagrancë ku ankuesi ka pasur statusin e të dyshuarit për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, duke pretenduar si të vërtetuar ato veprime të cilat ndërkohë ishin objekt shqyrtimi nga ana e një juridiksioni tjetër, e më konkretisht nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë dhe Gjykata e Shkallës së Parë Kavajë të cilat kishin nisur veprimet e para hetimore ndaj tij lidhur me ngjarjen e ndodhur në ambientet e dhomave të sigurisë të Komisarariatit të Policisë Kavajë në datën 04.05.2022 ku u vetëvar i ndjeri I.M.. Ky qëndrim përbën shkelje të të drejtës themelore kushtetuese të prezumimit të pafajësisë e sanksionuar në nenin 30 të Kushtetutës.⁸

Nga ankesa dhe aktet e përshkruara më sipër rezulton në mënyrë të qartë se për të njëjtin fakt ndaj ankuesit ka filluar një procedim penal. Në kushtet kur hetimi disiplinor është i ndërvarur drejtpërdrejt nga një vendim i një organi tjetër i zbatimit të ligjit, konkretisht Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë dhe Gjykata e Shkallës së Parë Kavajë, strukturat e Policisë së Shtetit duhet të kishin pezulluar hetimin disiplinor deri në përfundimin e çështjes penale në ngarkim të tij me vendim të formës së prerë.

Ky konkluzion bazohet në nenin 66/1 "Çështjet paraprake" të K.Pr.A. ku parashikohet se:

"1. Nëse organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër, organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë".

Gjithashtu ai gjen mbështetje të plotë edhe në Rregulloren e Policisë, respektivisht në nenin 225 të saj me emërtimin "Pezullimi i hetimeve", i cili përcakton se:

"1. Hetimi disiplinor për shkelje të rëndë disiplinore pezullohet nga Drejtori i Standardeve Profesionale, në këto raste: a) kur për të njëjtën çështje pritet një vendim-njoftim nga një organ tjetër i zbatimit të ligjit;"

Ndërkohë sjellim në vëmendje se edhe në nenin 230 të Rregullores, në pikën 4 dhe 5 parashikohet se:

"4. Kur gjatë hetimit disiplinor, provat dhe faktet janë të pamjaftueshme për të vërtetuar shkeljen e kryer dhe kur punonjësi i nënshtrohet hetimit penal, hetimi disiplinor mund të pezullohet nga Drejtoria e Standardeve Profesionale."

⁸ "Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë".

5. Në këtë rast hetimi disiplinor rifillon pas marrjes së vendimit të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, prokurorisë ose gjykatës.”

Sikurse parashtroam edhe më sipër, me Vendimin nr. 203, datë 10.02.2022 të Zv.Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, është vendosur pezullimi disiplinor nga detyra i ankuesit. Kjo masë është bazuar në nenin 222, pika 1, pika 3 gërma “d”, pikat 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11 të Rregullores, pasi në datën 05.05.2022, ai është arrestuar në kushtet e flagrancës nga AMP-ja dhe se ndaj tij Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë kishte filluar një procedim penal dhe Gjykata e Shkallës së Parë Kavajë ka caktuar masën e sigurimit personal “Arrest në burg” si person i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga nenet 248 e 25 të Kodit Penal. Gjithashtu në këtë vendim është parashikuar se *pezullimi do të zgjasë deri në ndryshimin e statusit të tij me vendim gjyqësor.*

Ne vlerësojmë se pezullimi disiplinor nga detyra i ankuesit me Vendimin nr. 203, datë 10.02.2022 të Zv.Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, është një masë e drejtë dhe e bazuar jo vetëm në nenin 222, pika 1, pika 3 gërma “d”, pikat 6, 8, 9 të Rregullores, sikurse është referuar në vendimin e pezullimit, por edhe në nenin 67/1 “Vendimet e ndërmjetme” të K.Pr.A. ku parashikohet se:

“1. Organi publik, që është kompetent për marrjen e vendimit përfundimtar, mund të marrë edhe vendime të ndërmjetme, kur gjykohet se mosmarrja e masave të caktuara do të shkaktonte një dëm të rëndë e të pariparueshëm mbi interesin publik, apo të drejtave ose interesave të ligjshëm të palëve”.

Ndërsa ndërprerja e pezullimit disiplinor nga detyra të ankuesit me Vendimin nr. 289, datë 21.06.2022, të Drejtorit të Departamentit për Sigurinë Publike në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Urdhrin nr. 1657, datë 12.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shteti “Për përjashtimin nga Policia e Shtetit të punonjësit të policisë P.B.” është bërë në kundërshtim të plotë dhe të hapur me nenin 68 “Përfundimi i vendimeve të ndërmjetme” të K.Pr.A. ku parashikohet se:

“1. Vendimet e ndërmjetme përfundojnë automatikisht në rastet e mëposhtme:

a) përfundon procedura administrative ose mbaron afati, brenda të cilit duhet të ishte dhënë vendimi përfundimtar;

b) kur mbaron afati i caktuar në vendimin e ndërmjetëm;

c) në rastet e tjera të parashikuara shprehimisht me ligj.

2. Organi publik shfuqizon vendimet e ndërmjetme, nëse gjatë procedurës bie shkak i parashikuar në pikën 1, të nenit 67, të këtij Kodi”.

Referuar kësaj dispozite ligjore dhe akteve administrative të cituara më sipër rezulton se:

a) Afati i pezullimit të ankuesit nga detyra “deri në ndryshimin e statusit të tij me vendim gjyqësor”, i përcaktuar në Vendimin nr. 203, datë 10.02.2022 të Zv.Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, i cili në kuptim të nenit 67/1 të K.Pr.A. është një vendim i ndërmjetëm, nuk kishte përfunduar ende sepse ndaj tij nuk ishte dhënë ndonjë

vendim gjyqësor për procedimin penal të filluar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë.

b) Shkaku për të cilin ishte vendosur pezullimi nga detyra i ankuesit, “si person i arrestuar”, nuk kishte rënë ende. Ai këtë status e ka pasur që në kohën e nxjerrjes së Vendimit nr. 203, datë 10.02.2022, të Zv.Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, dhe deri sa çështja penale e filluar në ngarkim të tij u pushua me vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë nr. 220, datë 28.12.2022, i cili ka marrë formë të prerë në datën 13.01.2023.

Në përgjigjen tuaj ju na informoni se *bazuar në nenin 251 të Rregullores së Policisë së Shtetit, masat disiplinore “Përrjashtim nga Policia”, nuk mund të hiqen nga Drejtori i Policisë së Shtetit.*

Gjithashtu, në vijim shpreheni se, *në zbatim të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe Rregullores së Policisë së Shtetit, e ndryshuar, për heqjen e masës disiplinore “Përrjashtim nga Policia”, z. B. duhet t’i drejtohet gjykatës dhe pasi të marrë një vendim të formës së prerë, mund t’i drejtohet Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për rikthimin e tij në strukturat e Policisë së Shtetit.*

Lidhur me këtë problematikë ju bëjmë me dije se, sipas akteve normative në fuqi që rregullojnë veprimtarinë e Policisë së Shtetit, tashmë punonjësit e policisë gëzojnë mbrojtje ligjore për t’u rikthyer në punë nëse përjashtohen apo lirohen në kundërshtim me ligjin. Ky qëndrim është konsoliduar edhe nga praktika gjyqësore, veçanërisht me vendimin Nr.00-2020-157, datë 01.07.2020, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Ndër të tjerash, në pikën 36 të këtij vendimi, Gjykata shprehet se: “..., nëse punonjësi i Policisë së Shtetit është larguar nga detyra në kundërshtim me ligjin, qoftë nëpërmjet përjashtimit të tij qoftë nëpërmjet lirimit, rezultati i vetëm i një konstatimi të tillë është rikthimi i këtij punonjësi në detyrën e mëparshme dhe pagimi i pagave që nga momenti i largimit, ...”

Ndërkohë në këtë vendim, në pikën 50, Gjykata shprehet se: “Në të njëjtën kohë, lidhur me efektet financiare që do të sjellë për palën e paditur ky vendim, kjo e fundit mund të përdorë në favor të saj dispozitat e ligjit nr. 8510, datë 15.07.1999, “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”, duke kërkuar me padi regresi, çdo shumë të paguar në favor të paditësit, nëse provohet, në kushtet e nenit 4 të këtij ligji, veprimi me keqbesim i funksionarit shtetëror që ka sjellë lindjen e mosmarrëveshjes”.

Sikurse argumentuam më sipër, ish punonjësi i policisë P.B. është larguar në mënyrë të kundërligjshme nga Policia e Shtetit. Sipas vlerësimit tonë, nëse ankuesi do t’i drejtohet gjykatës duke ngritur padi ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, sikurse sugjeroni ju, në situatën aktuale në të cilën ndodhen gjykatat tona për shkak të ngarkesës së madhe që kanë dhe numrit të reduktuar të gjyqtarëve për shkak të largimit nga procesi i vetingut të një numri të konsiderueshëm të gjyqtarëve, gjykimi i çështjes do të zvarritet me vite në mos kalon një dekadë. Derisa të përfundojë gjykimi i çështjes së tij, për shkak

se ai aktualisht është pothuajse 62 vjeç do të ketë plotësuar moshën e daljes në pension pleqërie. Pra, në këto rrethana përveç dëmshpërblimit financiar për përjashtimin në kundërshtim me ligjin, rikthimi i tij në Policinë e Shtetit do të ngelet vetëm opsion ligjor, por i porealizuar në fakt.

Në përmbyllje të hetimit tonë administrativ, vlerësojmë se aktet administrative të nxjerra ndaj ankuesit P.B. janë akte të paligjshme në kuptim të parashikimeve të nenit 109 të K.Pr.A⁹.

Gjithashtu ne vlerësojmë se për shkak të këtyre akteve ankuesit i janë shkaktuar pasoja të rënda profesionale, financiare dhe morale, duke i cënuar të drejtën e mbrojtjes shoqërore në punë e sanksionuar në nenin 49 të Kushtetutës.

Është rasti të theksojmë se largimet nga detyra të punonjësve të Policisë së Shtetit në kundërshtim me ligjin sjellin pasoja financiare e morale ndaj të larguarve, si dhe demotivojnë punonjësit në detyrë. Ndërkohë nuk duhet të lemë në harresë faktin se këto largime i shkaktojnë një dëm financiar të konsiderueshëm edhe buxhetit të shtetit si pasojë e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjykatat në favor të të larguarve nga Policia e Shtetit për pagimin e pagave që nga momenti i largimit deri në rikthimin e tyre në detyrë, si dhe për shpenzimet gjyqësore e përmbartimore. Për këto arsye dhe me qëllim parandalimin e pasojave të përmendura më sipër, nga strukturat kompetente të Policisë së Shtetit kërkohet që në rastet e fillimit të procedurave administrative disiplinore të veprojnë në përputhje me aktet normative ligjore e nënligjore në fuqi, të zbatojnë me korrektesë procedurat përkatëse si dhe respektojnë të drejtat ligjore të punonjësve të policisë.

Ndodhur në këto rrethana, kur akti administrativ në fjalë ndonëse i paligjshëm është ende në fuqi dhe vazhdon të sjellë pasoja duke cenuar të drejtat ligjore të ankuesit, në vijim të kryerjes së misionit kushtetues e ligjor në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend dhe me qëllim rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura ankuesit, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”, në nenin 21/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të

⁹ Paligjshmëria e aktit administrativ

Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:

- a) organi publik që e ka nxjerrë ka vepruar në mungesë të kompetencës;*
- b) është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative;*
- c) është në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ;*
- ç) është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas pikës 2, të nenit 4, të këtij Kodi;*
- d) është në kundërshtim me ligjin material;*
- dh) është rezultat i diskrecionit të ushtruar në mënyrë jo të ligjshme; apo*
- e) nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit.*

drejtave dhe lirive”, si dhe në nenet 109/b/d/dh (të cilin e kemi cituar më sipër) dhe 113¹⁰ dhe 117/2¹¹ të Kodit të Procedurës Administrative;

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të nevojshme për shfuqizimin e Vendimit nr. 289, datë 21.06.2022, të Drejtorit të Departamentit për Sigurinë Publike në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për dhënien e masës disiplinore “Përfjashtim nga Policia” Nënkomisar P.B. dhe Urdhrit nr. 1657, datë 12.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për përfjashtimin nga Policia e Shtetit të një punonjësi policie” Nënkomisar P.B. dhe rikthimin e tij në strukturat e Policisë së Shtetit.

2. Analizimin e shkeljeve ligjore të kryera nga strukturat e Policisë së Shtetit (Drejtoria e Standardeve Profesionale) gjatë procedurës administrative të kryer ndaj ish punonjësit të policisë P.B., nxjerrjen e përgjegjësive ligjore dhe marrjen e masave përkatëse ndaj personave përgjegjës.

3. Përgjithësimin e këtij rasti në strukturat vendore e qendrore të cilat kanë si detyrë funksionale verifikimin dhe hetimin e shkeljeve disiplinore të kryera nga punonjësit e Policisë së Shtetit, me qëllim respektimin e të gjitha procedurave dhe të drejtave ligjore të punonjësve të policisë në rastet kur ndaj tyre fillon një proces administrativ/ecuri disiplinore dhe mos përsëritjen në të ardhmen të këtyre shkeljeve.

Për qëndrimin që do të mbani ndaj këtij rekomandimi dhe masat që do të merrni për zbatimin e tij, na vini në dijeni brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, konform nenit 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

¹⁰ Neni 113 “Procedura dhe pasojat e anulimit dhe shfuqizimit”

1. Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin, nga organi i tij epror apo nga një organ tjetër i parashikuar shprehimisht me ligj.

2. Anulimi i një akti administrativ ka pasojë për të shkuarën, ndërsa shfuqizimi i aktit administrativ ka pasojë vetëm për të ardhmen. Anulimi dhe shfuqizimi mund të jenë të pjesshëm apo të tërësishëm.

3. Anulimi ose shfuqizimi bëhen me një akt të ri me shkrim, i cili anulon, shfuqizon, ndryshon apo plotëson aktin e parë.

¹¹ Neni 117

Afati për anulimin dhe shfuqizimin

1. Shfuqizimi, në rastin e parashikuar në pikën 1, të nenit 116, të këtij Kodi, mund të bëhet në çdo kohë.

2. Në çdo rast tjetër, të ndryshëm nga ai i parashikuar në pikën 1, të këtij neni, anulimi ose shfuqizimi mund të bëhet brenda 30 ditëve nga dita kur organi publik është njohur me faktet që çojnë në anulimin ose shfuqizimin, por jo më vonë se 5 vjet nga njoftimi i aktit administrative.

Ermonela Ruspi